

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr./Br. 507117
14.12.17

PRISHTINË - PRISTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Ankesë kundër **KUVENDIN KOMUNAL TE DRAGASHIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit: 621-17-2649-5-1-1

Sa i përket tenderit: **Ujësjiellësi Kryesor – Vazhdim i Punimeve (Projekt tre vjekar)**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

KONSORCIUMI PUNA Sh.p.k & N.N INFRA PLUS
(Emri i Operatorit Ekonomik)

Rr. Tahir Sinani, Blloku C2/B-Prizren , Rr. Luan Haradinaj Sol.1 H.1 - Prishtinë
(Adresa)

Prizren, Prishtinë
(Vendi)

20010, 10000
(Kodi postar)


044 154 27
(Numri Telefonit)


(Numri i Faks-it)

Ylber Halili
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ylber.halili@hotmail.com
(Adresa elektronike)

14.12.2017
(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vulë)



5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëturjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1-Qëllimi
- Neni 6-Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7-Barazia në trajtim/Jo Diskriminim i LPP
- Neni 56-Dispozitat e përgjithshëm mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënie e kontratave
- Neni 59-Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve i LPP
- Neni 60- Kriteret për Dhënie e Kontratës
- Vendimi PSH. Nr. 392,400/17

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë Grupin e Operatoreve Ekonomik: N.P.T Fanaj inxhinierig & Lala sh.p.k të cilët nuk i kanë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Pas kërkesës që kemi bërë për qasje në dokumente, kemi siguruar një kopje të dokumenteve të këtij konsorciumi shihet qartë se i mungojnë këto dokumente dhe janë të papërgjegjshëm:

- Konsorciumit N.P.T Fanaj inxhinierig & Lala sh.p.k i mungojnë: Qarkullimi financiar nga banka, apo deklarata vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit 2014,2015,2016 (siç kërkohet në FTD 8.1 dhe 8.2)

Nuk e plotësojnë kriterin sipas FDT

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor gjatë 3 viteve të fundit (2014,2015,2016) ka qenë në vlerë së bashku në tri vitet e fundit prej

jo më pak se (4 043 648.00 €)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Pasqyrat financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e fundit (2014,2015,2016), apo deklarata tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit - (2014,2015,2016)

Sqarim

Kurse Operatori Ekonomik N.P.T. Fanaj Injinierring ka ofruar deklarata vjetore të ATK-së që gjatë 3 viteve të fundit (2014,2015,2016) është 961,422.33€.

Kurse OE LALA sh.p.k i ka dorëzu vetëm pasqyrat financiare, ndërsa i mungon qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e fundit (2014,2015,2016) apo deklarata tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit - (2014,2015,2016) siç kërkohet në *Dëshmia e kërkuar dokumentare*. Pra grupi I OE nuk ka qarkullim (4 043 648.00 €) siç kërkohet në III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar, prandaj në mungesë të këtyre dokumenteve ky konsorcium është i papërgjegjshëm, pasi që për të qenë një operator ekonomik i përgjegjshëm duhet ti plotësojë të gjitha kërkesat e FDT dhe të njoftimit për kontratë. Kjo parashihet edhe në nenin 59 paragrafi 4 i Ligjit për prokurim publik ku ceket se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit:

- Poashtu Grupi i Operatorëve Ekonomik:N.P.T. Fanaj Injinierring, LALA sh.p.k pas qasjes që kemi bërë në dokumente zyrtare në Listën e Kontratave periudhën e shkurt tre vjeçare 2014,2015,2016 për punë të lëmisë së kërkuar nuk e arrin vlerën prej 3,032.736.00 € siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë. (siç kërkohet në FTD 9.1 dhe 9.2 nën c), prandaj është i papërgjegjshëm edhe për këtë pikë sepse kërkesë e FDT është lëmia e kërkuar e nuk mund të merren parasysh kontrata të ndërtimitarise si lëmi e kërkuar. Pra kërkesa është e qartë.

Sipas listës së kontratave e OE N.P.T. Fanaj Injinierring:

1. Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Mazrek të Hasit KK Prizren

Kjo kontratë është nënshkruar me dt.04/10/2013 ku sipas kontratës Neni 1.9 Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 40 ditë pune

Kërkesa sipas FDT

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

c) Kontrata të realizuara jo më pak se (3 032 736.00 €) të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkurt tre vjeçare: (2014,2015,2016)

Kjo kontratë nuk duhet të pranohet sepse nuk është konform kërkesës së FDT. III.2.4) c)

(Nuk përfshihet në periudhën e kërkuar 2014,2015,2016)

3.Renovimi i Objektivit të postës në Mitrovicë

Kjo kontratë është nënshkruar me dt: 11/03/2014

Kërkesa sipas FDT

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: